REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**VENDIM**

Nr. 69, datë 24.03.2023

**PËR**

**"MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR PROKUROREN DOLOREZA MUSABELLIU"**

Bazuar në nenin 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, në nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,* në germën "a", të pikës 1, të nenit 189, të ligjit Nr.115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar*, në nenin 8 të Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë *"Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve"*, pasi u njoh me kërkesën me Nr.507 prot., datë 16.03.2023, dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit, konkretisht qenien ekspert për zonjën Doloreza Musabelliu, pranë OSCE, në kuadër të një projekti me fokus hetimin dhe gjykimin e veprave penale për trafikimin e qenieve njerëzore.
2. Veprimtaria jashtë funksionit do të ushtrohet për periudhën kohore 15 – 28 mars 2023, jashtë orarit zyrtar të punës.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Doloreza Musabelliu dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 24.03.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

| | | |
|---|---|---|
| **KRYETAR**<br>**Alfred Balla** | | **ZV/KRYETAR**<br>**Tartar Bazaj** |
| **ANËTAR**<br>**Sokol Stojani** | **ANËTAR**<br>**Bujar Sheshi** | **ANËTAR**<br>**Nurihan Seiti** |
| **ANËTAR**<br>**Eloida Goxhi** | **ANËTAR**<br>**Esmeralda Keshi** | **ANËTAR**<br>**Zeqir Hoda** |
| **ANËTAR**<br>**Mirela Bogdani** | **ANËTAR**<br>**Arta Mandro** | **ANËTAR**<br>**Ledina Riza** |